

Nuhi Vinca

PËR KËNGËT E MOTMOTIT NË REGJIONIN E STRUGËS

Të studiosh lirikën gojore të një regjioni nuk është punë e lehtë, sepse gjendesh para po atyre vështirësive që të dalin përpara kur studion lirikën e tërësishme të një kombi, sepse edhe farët edhe strukturat bashkë me shumë elemente të tjera janë pothuajse po ato. Të bësh përpjekje t'i qasesh kësaj krijimtarie, vështirësi të dyfishuara të dalin përpara: ajo rron, bën jetën e vet duke evoluar në popull si një organizëm i gjallë, është e pambledhur, e pabotuar, e pastudiuar. Ajo duket si një lirikë kombëtare në miniaturë. Shprehja lirike regjionale s'duhet të marrë kurrsesi mbi vete kompetenca vlerësimesh estetike sepse, nëse në kuptimin gjeografik kemi një regjion parasysh, në pikëpamje estetike lirika e një regjioni ose treve është me dimensione universale sepse është me dimensione të shpirtit njerëzor.

Është një veçori sa e çuditshme aq edhe tragjike për shqiptarët e këtij regjioni (mbase nuk është vetëm për shqiptarët e këtij regjioni) veçoria që përqëndrohet në faktin se ky popull, që kur pranio fenë islame dhe më herët, ka ushtruar si të thuash dy lloj normash paralelisht, në të njëjtën kohë. Dy lloj normash e botëkuptimesh u përpoqën të futen në kohën e tij: jeta e normave dhe e botëkuptimeve fetare, e ardhur dhe e imponuar nëpërmjet fesë dhe jeta e normave tradicionale, të vjetra. E gjatë që kjo luftë, aq sa po zgjat edhe në ditët tona. Karakteri konservator i festave dhe i këngëve të motmotit nuk do të ish aq konsekuent dhe deri diku i pamposhtur, sikur festat e reja të kishin thellësisht karakterin më progresiv (si rezultat të rrethanave në zhvillimin dialektik) e sikur t'u përgjigjeshin etnopsikologjisë së popullit, gjithmonë varur dhe kushtëzuar nga rrethanat ekonomiko-shoqërore, se „nacionet morale ndryshojnë bashkë me ndërrimet e atyre kushteve, në të cilat jetojnë njerëzit”.¹ Kështu, kur është fjala për këngët e ritet e motmotit, ithtarët e fesë islame (në regjionin tonë) bashkë me përfaqësuesit e asaj feje, në institucionin fetar-xhaminë, s'guxuan as t'i përmendin as t'i respektojnë, por përkundrazi i luftuan, kurse me të ardhur në shtëpi, bota femërore e fëmijët bashkë me burrat, va-

¹ G. V. Plehanov: *Umetnost i književnost I*, Kultura, Beograd, 1966, f. 18.

zhduan t'i ushtrojnë ritet dhe t'i këndojnë këngët e Ditës së Verës, të Nevruzit, Shën Gjergjit, të Eremisë, të Majit e të Shën Mitrit. U festuan në vazhdimësi shekujsh dhe festohen edhe sot...². Kështu, pra, për shqiptarët e këtij regjioni nëpër shekuj mbetën dy lloj festash: ato të vjetrat dhe festat e reja të fesë islame. Dhe nuk mund të themi që të dy llojet nuk patën karakter masiv. Ndërsa festat e ritet depërtuan në masë, kangët për to e lidhur me to nuk mbetën gjithmonë masive, sepse ndërruan edhe kushtet ekonomike e shoqërore që i lindën. Shkencëtarë të ndryshëm si Plehanovi e Gjuriqi, kur kanë studiuar lindjen e lëtërsisë, në plan të përgjithshëm kanë pasur parasysh botëkuptimin e drejtë shkencor: materializmin historik që shkurtimisht do të mund të përmbledhej në fjalët e parafrazuara të Plehanovit — në historinë e njerëzimit ndryshojnë marrëdhëniet e prodhimit. Kjo e orienton edhe krijimtarinë artistike.³ Botëkuptimet e drejta shkencore i ka përqaftuar edhe shkenca shqiptare, qoftë folklorike apo ajo e fushave të tjera. Kështu tani kemi një varg studiuesish që i kanë konkretizuar këto pikëpamje shkencore duke i bazuar në mendimet largpamëse të klasikëve të marksizmit.

Të hedhësh vështrimin mbi këngët e motmotit në gjendjen e sotme, nuk është e mundur të mos mendosh për lashtësitë pagane të burimit të tyre, edhe pse fetë monoteiste kanë bërë përpjekje duke i luftuar këto, në mënyrë permanente ose duke u përpejkur t'i mpleksin me elemente të reja të fesë kristiane ose islame, duke dashur t'i bëjnë si festa të tyre.

Të flasësh mbi këngët e motmotit, detyrohesh të bësh përpjekje imagjinate për të parë me sytë e mendjes normat e kohës pagane dhe besimet e stërgjyshërve tanë. Sepse dihet mirëfilli: këto këngë janë shumë të vjetra. Ato janë ndërruar gjatë shekujve, siç janë ndërruar marrëdhëniet e prodhimit, e me to edhe vetëdija njerëzore.

Po cilat janë këto festa e këto këngë?

Një pjesë relativisht të vogël të lirikës së këtij regjioni zënë këngët e motmotit. Ky proporcion është analog edhe me gjithë li-

² Kur flasim për këngët e motmotit dhe ritualet e tyre si për diçka të kaluar, fshatarët menjëherë shtojnë se edhe sot ka familje që i bëjnë ritet dhe i këndojnë këngët, duke e ekskluduar veten sepse të respektuarit e tyre i konsiderojnë si diç të vjetëruar. Dhe jo vetëm kaq. Në Veleshtë, në pranverë të vitit 1974 në familjen e Nexhat Vincës (68 vjeç) ishin të pranishëm edhe disa pleq, të cilët kundërshtuan të flasim e të tregojnë për këto festa, sepse sipas fesë islame nuk duhet të festohen ose siç thonë ata, janë „haram“, duke shtuar se në atë mënyrë u kanë folur në xhami. Ky fakt e vërteton edhe njëherë të vërtetën që e kanë thënë dhe kanë pohuar shkencëtarët dhe studiuesit e folklorit se këto festa e këto këngë kanë qëndruar akoma të gjalla edhe përballë luftës që u kanë shpallur fetë, qofshin ato kristiane apo islame.

³ Shih Vojislav Gjuriqin: *Postanak i razvoj narodne književnosti*, Znanje, Beograd, f. 85, 1954, ku thekson se këto këngë, si edhe shumë të tjera kur u paraqit shoqëria klasore, filluan të paraqesin antagonizmat e klasave dhe se me zhvillimin e kulturës raporti mitologjik ndaj natyrës dobësohet, zhduket.

rikën gojore shqiptare. Këngët lidhen me festat rituale të motmotit që në këtë regjion janë gjithse, pesë: katër që ushtrohen gjatë stinës së pranverës në data të caktuara, kurse një në vjeshtë. Këto janë: Dita e verës që festohet më 13 dhe 14 mars, pra gjatë dy ditëve. Dita e parë quhet Dita e luleve dhe e dyta Dita e zogjve. Gjatë këtyre dy ditëve bëhet një varg rimesh. Përgatitjet për Ditën e luleve bëhen qysh në mbrëmjen e 13 marsit. Gratë „thkinë” qiqra që do të thotë zënë bukë qiqrash, që zakonisht bëhen ditëve të kryemotit. Pasdarke bëhen disa rituale që janë të përhershme vetëm në Ditën e verës, e disa nga këto përsëriten edhe në ditët e festave të tjera të pranverës. Kështu në mbrëmje dredhin penj të bardhë e të kuq duke thënë: „bardh e kuq për verë, bardh e kuq për verë” që do të thotë se me këtë ritual dëshirohet shëndeti i fëmijës që të jetë i bardhë e i kuq, pra i shëndoshë gjatë gjithë verës. Këto penj fëmijëve u vihen në qafë ose në gisht me monedhë të shpuar, ndërsa të rriturve në gishtin e madh të këmbës. Kjo flet se Dita e verës do të ketë qenë e të gjitha shtresave të popullit, por me kalimin e kohës ka shkuar duke humbur karakterin e vjetër masiv.

Kur vjen mëngjesi i 13 marsit, fëmijët zgjohen shumë herët, marrin vezët e ziera dhe shkojnë për lule. Djemtë zakonisht marrin me vete „armën” e tyre primitive që quhet *bae*, e cila ka formën e një gjarpri, e gjatë afërsisht një metër dhe përbëhet nga këto tri pjesë: në krye ka vendin e gishtit ose siç e quajnë *shqekën* e gishtit, në mes i ka dy shqeka ose të çelura ku vihet guri, ndërsa në kënd është bishti i baes. Thuret me leckë nga fëmijët për të hedhur gurët me një forcë prej dyqind e më shumë metra largësi. Me to shpesh zhvillohen „luftëra” në dy „taborre”. Vajzat, duke shkuar për lule ose kur mbledhin lule, këndojnë këngë të ndryshme, ndër të cilat dallohet ajo me vargun e parë „Kur të shkoni moj ju për lule... Pos kësaj këndohet edhe ajo e kukurekut pikërisht në momentin kur takojnë lulen e kukurekut në mal. Në vendin ku kanë mbledhur lulet, fëmijët i hanë vezët e ziera një natë më parë. Ngrënia e vezëve mund të shpjegohet edhe si përpjekje për ruajtjen e shëndetit në mars, kur ushqimet e vendit janë të pakta dhe avitaminoze. Fëmijët marrin dushk, gogla, degë thëne me lule, kukurek dhe shkojnë në shtëpi, por lulet nuk i shtijnë brenda pa u kryer punët shtëpiake të ditës, por i lënë në obor, sepse, si të hyjnë lulet brenda, thonë plakët, nuk bën më të preket gjilpërë me dorë, as të bëhen punë të tjera. Një plakë shtatëdhjetë vjeçare nga fshati toskë Frengovë rikujtoi këto fjalë: „Ditën e luleve, kur kthenim nga mali, te dera e shtëpisë trokitim e thonim:

- Oj e zojë e shtëpisë?
- Ku i ke bythëzinjtë?
- Maleve, valëve, gurëve pashallarëve.

Mandej merrnim goglat me vrima dhe i shtienim aty pleshtat e i hidhnim”. Pasi të jenë kryer punët e shtëpisë, lulet renditen në-

për shtëpi, sidomos stoliset dera e shtëpisë, dorëzat e derës së ahrit si dhe anë e kënd shtëpia. Në mbrëmje plaka e shtëpisë temjatis skajet e themeleve e viset e ndryshme të shtëpisë për t'i larguar nga shtëpia gjarpërinjtë, bollat ose kafshët e tjera. Është karakteristike se nuk ua përmendin emrat, po qe se i pyet se çka janë duke bërë. Zatën provokohet dialogu: *çish bon ashtu? Çepi gjojfarkumt*, që përsëritet tri herë, duke marrë kështu karakter magjik e mistik. Kjo konsiston në zhdukjen e të këqijave që mund të vijnë nga rrëshqanorët që zgjohen në pranverë. Në fund të ditës së parë, pra ditës së luleve, bëhet edhe një rit që është i fundit i ditës së parë dhe i pari i ditës së nesërme, pra, *Ditës së zogjve*. Plakat ose gratë e tjera të shtëpisë që duhet të jenë së paku dy, marrin gurë në vijë, i bejnë grumbull duke imituar grumbullin e vezëve dhe thonë këtë dialog:

*Ciu ciu n'shpoj —
Lluk lluk n'komshoj.*

Nga kjo formulë zbulohet sa karakteri magjik aq edhe ai naiv. Të nesërmen, pra Ditën e zogjve, zakonisht nëna ose gjyshja zgjohet shumë herët (e para në shtëpi) dhe me degët e thënës shkon e i zgjon fëmijët nga gjumi duke thënë këto fjalë: „T'fortë si thona, T'fortë si thona, T'fortë si thona!” Kështu zgjohen fëmijët të uruar nga nëna që të jenë të fortë si thënë verës që vjen e që i pret. Ky urim në gojë të plakave duket se ka përdorim shumëshekullor, sepse kur shqiptohet pothuajse e ka humbur kuptimin e drejtë që vjen nga shqiptimi: „*Forcithona*”, shumë i shpejtë dhe rrëmbyeshëm saqë bashkimi i tri fjalëve në një e bën pothuajse të pakuptueshme domethënien.

Gjithë paraditja e Ditës së zogjve kalon në shenjë dëshire për t'u shtuar zogjtë. Kështu nëpër rrugët e fshatrave dëgjohen shumë zëra onomatopeikë të morisë së fëmijëve duke kënduar „ciu-ciu...” Para dymëve të fqinjëve dhe të farefisit duke mbajtur në duar një copë dru, karthi ose krande, të cilën ia dorëzojnë atij që del nga shtëpia për t'u shtuar zogjtë. Ata të shtëpisë i gostisin me vezë ose me fruta të ndryshme: arra, gështenja, mollë etj. Sepse ardhja në shtëpi me imitim e cicërimës së zogjve, është gëzim i madh si për fëmijët ashtu edhe për të zotin e shtëpisë, sepse kështu ndillet mbarsia e pjelloria për verën që po vjen.

Festat e tjera janë: Sullton Nevruzi, Shën Gjergji dhe Eremija. Të gjitha këto festa të vjetra kanë termine të caktuara që përputhen me të gjitha krahinat ku akoma ekzistojnë e ushtrohen. Kështu terminet e tyre janë: 14 mars — *Dita e verës*; 25 mars — *S. Nevruzi*; 23 prill (6 maj) — *Shën Gjergji*; 30 prill (14 maj) — *Eremija*.

E vetmja festë e cila bije në stinën e vjeshtës është Shën Mirti, më 26 shtator me kalendarin e vjetër ose më 8 tetor me kalendarin e ri.

Këngët kryesore nëpërmjet të cilave mund të nxirren karakteristikat themelore të tyre janë ato të Ditës së Verës, kur fëmijët shkojnë për lule, ato të Dordolecave, që ndjellin shiun, të Shën Gjergjit, të Eremisë, të majit, të shpendëve shtegëtarë etj. Tani, kur në shtëpinë e bujkut dhe të blegtorit kanë zënë vend mjetet e shpikjeve moderne teknike, që paralajmërojnë b.f. se si do të jetë koha për bujqësinë e blegtorinë, pra, tani kur ka depërtuar dituria e përgjithshme, këngët e motmotit me motivet e tyre janë në çastet e fundit. Koha e re me hov po hyn në jetë. Ajo krijon kushte të reja, njerëz të rinj dhe natyrisht këngë të reja, por këto që janë shndërrohen në ura lidhëse për të shkuar e për të shkelur me hapa të sigurtë në një botë të re e më progresive.

Këngët e motmotit nga ato të botës bujqësore, ose fushave të tjera flasin për një kohë të lashtë, atëherë kur të menduarit për fenomenet e natyrës e të jetës, bashkë me mënyrën e prodhimit material, ishin në një shkallë të pazhvilluar. Atëherë në mendjen e njeriut lindi mistika dhe fantastikja pra një bindje pagane.

Edhe njeriut të këtij regjioni, si çdokujt tjetër në rruzullin tokësor, në stadin përkatës të zhvillimit, i gjetur kësisoj para fenomeneve të pakapshme të natyrës si dhe para shumë nocioneve abstrakte të jetës e vdekjes, i lindi dëshira që t'i lutet lules së parë në Ditën e e Verës e t'i thot:

*Kukureku i roj
Rumi sojt e moj:
Niçin e ni vjet
Kurrxho mos m'i xhett...*

ose në Ditën e Eremisë të shkojë për t'u larë në Drinin akoma të ftohtë, më 14 maj e t'i përsërisë me fjalët plot mistikë

Ujt teposht, shndeti terma...etj.

duke kënaqur kështu jo shijen estetike për të kënduar, por ata që i duhen më së shumti për punë: sytë, aftësitë e të menduarit, sepse kukureku është lule e paerë kundër marrëzisë. Pra, ndillet shëndeti, dobia, utilitariteti. Karakteri i punës dhe ai utilitar manifestohet edhe te fjalët që ndihen nëpër kopshtet e pemëve, kur dy veta, me kashtën e thekrit ndër sjetull dhe me sopatën në duar, u afrohen pemëve një nga një dhe u thonë këtë dialog: „A ta pres? / — Jo se ban me thes. / A ta hosh? / — Po se ban me kosh, / A t'i sojll*? / — Mo s'e bon me kojll** / .

Ndër këngët e motmotit nuk janë primare vlerat estetike si qëllim i këngëtarit të popullit. Primare janë komponente të tjera që zanafillën e kanë në vetëdijën e njerëzve që jetojnë në gjirin

* Sojll — godas.

** kojll — masë për peshë afër 100 kgr.

e shoqërisë të prirë nga botëkuptimet e lidhura me themelet e kushteve jetësore. Prandaj këto këngë janë studiuar me qasje më komplekse sidomos në relacionin letërsi-shoqëri-religjion e relacione të tjera.

Kështu kanë vepruar edhe studiuesit tanë në Historinë e letërsisë shqipe, ndër punime të veçanta ose në referate që kanë paraqitur në simpoziumet ndërkombëtare të folklorit: Prof. Z. Sako, Dr. Sh. Pllana, R. Sokoli, Gj. Komnino, Q. Haxhihasani, A. Mustaqi, D. Shala etj.⁴ Në rrethin e gjerë të këtyre studiuesve të këtyre këngëve vetëm Dr. Sh. Pllana ka prekur edhe këngët e regjionit për të cilin e kemi fjalën. Kështu në studimin e tij „Këngë kalendarike” lexuar në Simpoziumin Ballkanik të Folklorit në Ohër theksoi në plan krahasimtar këngën e Majit shënuar në Veleshtë të Strugës. Kënga është e botuar në „Jeta e re” 5/1962 bashkë me disa të tjera të këtij lloji dhe ka këtë tekst:

*Maj, maj, kokomaj
Rrojtmi fjokët
Sa t'i mbaj,
Për ni javë
Sa ni stavë.
Për ni muj
Sa ni duj,
Për ni vjet
Sa ni qep*
Sa bisht'i kalit
Sa litari i samarit
Sa udh' e pazarit... etj.*

Për këtë këngë edhe në Gjurmime albanologjike edhe në Makedonski Folklor⁵ — u theksuan fjalë të një vlerësimi pozitiv, me të ci-

⁴ Shih: Z. Sako: *Dita e verës, ritualet dhe këngët për të*, pjesë nga kumtesa e lexuar në Simpoziumin ndërkombëtar të folklorit në Ohër, Rilindja, 8. IX 1973, f. 14.

* qep — em. plepi.

⁵ Shih: Sh. Pllana: *Kalendarske majske pesme albanaca na Kosovu i Makedoniji*, Makedonski Folklor, nr. 3—4, Shkup, 1969, f. 129—133, ku ndër të tjera ka prekur këngën *Maj, maj kokomaj* me këtë shënim: si rezultat i lidhjes së pashkëputshme të popullit me muajin maj, që e konsideron si mbretin e muajve, për shkak se zgjon natyrën dhe njeriun, lindën këngë maji në Kosovë e Maqedoni, me të cilat këngë fëmijët, sidomos vashat lusin majin t'u falë flokë të gjata... Shembuj të tillë të këngëve të majit të shqiptarët kanë shënuar që nga shekulli i kaluar Th. Mitko, S. Dine etj. e deri në ditët tona. Ne do të flasim vetëm për dy shembuj të spikatur nga tereni ynë, nga të cilët shembulli i shënuar në Veleshtë, rrethi i Strugës me titull *Maj maj kokomaj* është regjistruar dhe botuar nga Nuhi Vinca. Këtë këngë autori i studimit në fjalë e ka marrë nga „Jeta e re” nr. 5/1962, f. 766. E theksojmë këtë dukuri se pas çlirimit, ky studiues është i pari që ka vërejtur anën poetike të këngëve lirike të Strugës. Po ky studiues edhe në „Gj. Albanologjike” 2/1965, f. 267 në punimin „Këngët e motmotit ndër shqiptarë” thekson për këtë këngë se ka krahasime të bukura.

lat kjo këngë del si njëra nga variantet më të bukura në llojin e vet në gjithë lirikën shqipe. Kur e theksojmë faktin se këto këngë nuk shquhen shumë për vlerat estetike, nuk mohojmë këto vlera edhe për disa këngë të reja si kjo e majit dhe ajo e mbledhjes së luleve, në të cilën vërehen elemente poetike të një niveli pak më të lartë. Në këto këngë është prezente një ndjenjë e ngrohtë që qarkullon nëpër vargjet me shprehje figurative të qëlluara. Kënga e luleve është e përhapur mjaft. Dihet se nga kjo këngë u frymëzua edhe Lasgush Poradeci. Siç na njofton Dh. Shuteriqi në veprën e tij „Nëpër shekuj letrarë” (Tiranë, 1973, f. 12 e 13) variantën e kësaj kënge e gjejmë edhe ndër arbëreshët: / *N'është gjarpëri që e zu / Kanë barëra fushat; / N'është dora që e ngau / Atë dorë ajo e do...* /.

Pas kësaj strofe vijon ky komentim: Vargjet e fundit të kësaj kënge janë njëlloj me vargjet e fundit të një kënge të viseve tona që edhe sot dëgjohen në fshatrat e Pogradecit — „*N'e zu gjarpëri u shëroftë / N'e zu trimi u trashëgoftë /*. Kjo e Pogradecit është një këngë pranverore, këngë lulësh, si i thonë, e cila, me sa kemi gjurmuar, ka të bëjë me këngët rituale të ringjalljes së natyrës në pranverë dhe këndohet ndër festa si Pashka dhe Dita e Verës...”.

Duke e veçuar këtë numër minimal këngësh që dallohen pak a shumë me ndjenjat e ngrohta që qarkulojnë në frymën poetike, këngët e tjera të motmotit nuk kanë veti të larta artistike siç ngjan me këngët e tjera të lirikës gojore. Dhe kjo e ka burimin në thënien që kanë pohuar Rene Veleku dhe Ostin Voreni: „Në shoqërinë primitive është e pamunduar të ndahet poezia nga riti, magjia dhe puna ose loja”.⁶

Në qoftë se shkenca dhe mënyra e prodhimit do të kishin arritur gjer në atë shkallë saqë njeriu të medojë e të dijë se si shkaktohet shiu, me siguri s'do të lindte kënga e Dordolecit:

*Dordolec, Dordolec,
Bon dua t'gjere shoj
T'boen mojsrat me kalloj... etj.*

Kënga është një lutje për të rënë shi dhe manifeston më shumë shpirtin fetar sesa atë poetik.⁷

⁶ R. Velek — O. Voren: *Teorija književnosti*, Beograd, 1974, dr. izd. f. 120.

⁷ Kjo këngë e shënuar nga N. Vinca është e botuar në numrin 5 të „*Jetës së re*” të vitit 1962, prej nga e ka marrë D. Shala dhe e ka rikopieruar pak gabime edhe në „*Letërsia popullore shqiptare*” EBT, Prishtinë, 1974 në f. 21. Në këtë vepër të tij të fundit kënga ka dalë e deformuar, për shkak të mosnjohjes së gjulës së vendit. Kështu ai ka marrë qëndrimin e sqaruesit dhe në vend që të shkoqisë fjalët e panjohura, ai trajtës „*gjive-shoj*” (sic!) i jep kuptimin që s'e ka. Pos kësaj trajte ai ka ndërruar kuptimin edhe të disa fjaleve në tjera. Kështu fjalën *kalloj* që do të thotë *kallinj*, e ka sqaruar gabimisht duke thënë se ka kuptimin e fjalës *kollaj*, duke u zvetënuar kështu vlera estetike e këngës në fjalë.

Kur e theksojmë anën konservatore e konsekuente të këtyre këngëve ndaj petkut religjioz postpaganik dhe luftës që i patën shpallur fetë monoteiste, e konsiderojmë të nevojshme të përmendim një fabul interesante dhe alegorike që e dëgjuam dhe e shënuam në fshatin Veleshtë kah viti 1959 e që është e përkapur: („Shëngjergji ene Beromi ranë niherë përniditë. U mblodhën burrat e katundit ta bisedojnë punën se collin ta mbajnë — Beromin apo Shëngjergjin. Po dul ni ma qak e tha: More burra, ne mbajmë Shën Gjergjin se aj s'lun a Beromi osht b... lujtun. Ene kshtu ata e mbajtën Shën Gjergjin e jo Beromin...”).

Në këtë fabul pra bëhet fjalë për Shën Gjergjin dhe Bajramin, duke e favorizuar të parin si rezistues, konsekuent dhe stabil, sepse *nuk ndërrohet, nuk luan kurrë*, vjen gjithnjë në të njëjtën ditë e jo si Bajrami që luan. Kjo fabul duhet të jetë edhe origjinale edhe mjaft e vjetër, aq sa duhet të lidhet me përhapjen e fesë islame ndër këto vise, fesë, e cila, e imponuar me forma e mjete të ndryshme të një sunduesi, pretendoi të ushtrojë ndikimin e vet...

Kur njeriu mediton rreth këngëve të motmotit detyrohet spontanisht të pyesë: si është perspektiva e këtyre?

Rreth kësaj pyetjeje janë dhënë mjaft mendime nga studiuesit tanë. Mendimet e tyre përqendrohen në faktin se trajtat e vjetra dhe ritet dalngadalë zhduken, sepse llojet janë kategori historike që u nënshtrohen ndryshimeve të përhershme derisa një ditë shuhet këngët e ritet e para për t'ua zënë vendin këngët e reja. Kështu tani, në vend të këngëve të Ditëverës, Shën Gjergjit, linden të tjera që kanë për motiv të kremtet e sotme dhe natyrën pranverore ose stinët e ndryshme. Në këtë drejtim vlen të nënvizohen e të shihen mendimet e shfaqura siç është ai në Historinë e Letërsisë Shqipe, Prishtinë, 1968, f. 34 si dhe ai në kumtesën e Arsen Mustaqit me titull Këngët rituale të pranverës, rreth perspektivës së këtyre këngëve. Kështu në HLSh lexojmë: „Me zhvillimin e kohës, me përhapjen e teknikës dhe të njohurive shkencore, festat kanë përfunduar në lojna fëmijësh dhe janë braktisur. Po kështu edhe këngët janë bërë lojna fëmijësh dhe janë braktisur, të mbushura me vargje onomatopeike, që imitojnë zërin e kafshëve ose të shpendëve, me shaka ose dhe me fjalë të huaja, që vendasi nuk i kupton”. Këtë mendim e përsëriti edhe A. Mustaqi kur tha:

„Elementet degraduese duken po të shikosh këngët në gjendjen e tyre të fundit. Ato janë të mbushura me shaka e lodra fjalësh që shpesh përdoren për rimim të vargjeve e që s'kuptohen se çfarë shprehin ato”.⁸

Këto mendime e përforcojnë bindjen tonë se këngët e motmotit janë të dënuara të zhduken, sepse zhduken edhe botëkuptimet

⁸ Shih: A. Mustaqi: *Këngë rituale të pranverës*, Rilindja, 28. VII 1973, ku ndër të tjera thotë: „ata kanë mbetur në thelb krijime rituale pagane, dëshmi kjo e ndjenjës antifetare të popullit tonë”, që, kur e thotë këtë A. Mustaqi, do të ketë menduar ndoshta në ndjenjat antifetare myslimane a kristiane, se përndryshe edhe paganizmi është një konfesion.

ose mënyrat e prodhimit material, kurse perspektiva e tyre shihet në zëvendësimin me këngë të reja që u përgjigjen konteksteve të tjera kohore. Jemi të pritur të themi se dy janë komponentet determinuese të tyre: mënyra e prodhimit material si komponentë e parë dhe aktiviteti i vetëdijshëm njerëzor si komponentë e dytë.

Duke vëzhguar kompletaritetin e jetës së këngëve të motmotit, mund të numërojmë këto karakteristika themelore konkrete:

— se këto këngë janë më shumë tekste poetike që këndohen ose recitohen të skanduara me një melodi që anon kah recitimi, edhe pse nuk mungojnë edhe të tilla që kanë melodi të bukura;

— shumica nuk përcillen me instrumente siç ngjan me këngët e farët e tjera. Teksti i tyre nuk luhet valle, përveç asaj të dor-dolecit që ka një ceremoni të veçantë;

— shumica e këngëve e kanë të gjallë ritualin e vet dhe janë të lidhura ngushtë me të;

— se këngët vetë nuë janë më masive sesa ritet, të cilat i ushtrojnë edhe shtresat e të rriturve, d.m.th. riti dhe kënga nuk kanë përhapje të njëjtë;

— shprehin botëkuptime të një shkalle të ulët të civilizimit dhe se karakteri i tyre ndaj fenomeneve të natyrës është i varur nga raporti religjioz e paganik e pastaj mlekën nga fetë monoteiste, kristiane dhe islamike;

— janë ndër këngët më konservatore edhe pse s'kanë mbetur pa marrë elemente të reja postpaganike;

— struktura poetike e tyre është e larmishme, me gjashtërokshin dhe tetërrokshin e poezisë popullore shqipe në tërësi dhe me elementin e pranuar të rimës që në zanafillë nuk do ta kenë pasur etj.

Nuhi Vinca

LES CHANTS DU CYCLE DE L'ANNÉE DANS LA RÉGION DE STRUGA

Résumé

En examinant dans leur ensemble les chants et les rites du cycle de l'année qui se chantent dans la région de Struga nous pouvons distinguer les caractéristiques essentielles ou typiques particulières à ces chants:

— ce sont davantage des textes poétiques qui se chantent ou se récitent d'une façon scandée;

— la plupart d'entre eux conservent le rite qui les accompagnent et sont liés étroitement à lui;

— ils ne sont pas aussi diffusés que les rites et répartis de la même manière; Les rites sont plus vivants et plus nombreux;

— ils révèlent une conception du monde correspondant à un niveau de civilisation inférieure; leur caractère envers les phénomènes de la nature est en dépendance totale avec les éléments religieux et païens. Pour cette raison ils ont intégrés de nombreux éléments des religions qui sont apparues après le paganisme;

— ils ont conservé davantage que les autres chants les éléments de la tradition passée bien qu'ils ne soient pas exempts de nouveauté;

— le vers hexamètre et octosyllabique populaire domine. La rime est apparue plus tard car à l'origine elle n'existait pas;

— la valeur esthétique est de seconde importance, elle ne peut être prise en considération dans les chants récents surtout ceux qui sont inspirés par le printemps.